

Analizë e romanit “Nëpër shtigjet e ferrit” i Viktor Martinit

nga mësuese Merita Kastrati

Romani “Nëpër rrugët e ferrit” i shkrimtarit Viktor Martini paraqitet si një rrëfim i thellë autobiografik, një dëshmi e gjallë dhe tronditëse mbi një nga periudhat më të errëta të historisë shqiptare, kohën e komunizmit dhe mekanizmin çnjerëzor të luftës së klasave.

Ky roman nuk është thjesht një vepër letrare, por një dosje e hapur shpirtërore dhe historike për familjen Zef Martini Zogu, një familje e përndjekur, e goditur dhe e copëtuar nga dhuna sistematike e regjimit. Përmes një gjuhe të ngarkuar emocionalisht dhe një realizmi të ashpër, autori ndërton një univers ku dhimbja, rezistenca dhe dinjiteti njerëzor bashkëjetojnë në një tension të vazhdueshëm.

Në vepër takon figurën e Zef Martinit, patriotit që simbolizon qëndresën morale përballë padrejtësisë, bashkëshortes së tij Kaltrinės dhe djemve të tyre që u rritën nën persekutim me mungesën e babait duke vuajtur burgjeve.

Kaltrina Martini, një figurë e heshtur, por e pathyeshme, që mishëron sakrificën e nënës shqiptare...që djerret beteje pas beteje, por në shpirtin e saj që pasqyrohet nga sytë, skalitet burrënësia e pathyeshme.

Përmes tyre, lexuesi futet në një botë ku familja nuk është më strehë, por shënjestër.

Fëmijët e kësaj familjeje: Viktor Martini, Rodolf Martini, Paskual Martin, Ler Martini dhe Marie Martini, përfaqësojnë dimensione të ndryshme të përjetimit të ferrit komunist.

Viktori, si narrator dhe dëshmitar, mbart peshën e kujtesës dhe detyrimin për të rrëfyer edhe si një ish i burgosur politik me akuzën e sajuar nga ish sigurimi : ”*Tentativë arratisjeje*”

Vëllezërit e tij Rudolphi, Paskuali dhe Leri përjetojnë në mënyra të ndryshme burgun dhe torturat, duke shfaqur kontrastin mes shpresës dhe dëshpërimit

Ndërsa Maria, e aratur e ndihmuar nga dy vëllezërit më pas e martuar në ish-Jugosllavi, përfaqëson largësinë fizike, por jo shpirtërore nga tragjedia familjare, një plagë që nuk njihet kufij.

Mbi të gjitha qëndron në Kaltrinë që nuk u mposht as nga dënimi i të shoqit as nga vdekja e tij , as nga arratisja e së bijës ndihmuar nga dy vëllezërit e rritur të cilët u kthyen dhe u futën në burg, as nga arrestimi i dy djemve të tjerë, por me shpresën të Zotit dhe me qytetarinë e saj i edukoi fëmijët që të mos e ulnin kokën e mos e humbnin dinjitetin.

Romani ndërtohet si një udhëtim nëpër “shtigjet e ferrit”, ku ferri nuk është metaforë, por realitet konkret: qelitë e ftohta, hetuesitë brutale, izolimi, uria dhe frika. Megjithatë, brenda këtij errësimi

total, autori arrin të ndezë dritëza humanizmi momente të vogla solidariteti, kujtime familjare dhe shpresa që refuzon të shuhet.

Stili i Viktor Martinit është i drejtpërdrejtë, shpesh i zhveshur nga zbukurimet, por pikërisht kjo e bën më të fuqishëm. Ai nuk kërkon të romantizojë vuajtjen, por ta dëshmojë atë me ndershmëri të plotë, duke e kthyer romanin në një akt kujtese kolektive dhe një thirrje për reflektim historik.

“Nëpër shtigjet e ferrit” është, në thelb, një monument letrar për viktimat e heshtura, një përpjekje për të mos lejuar harresën dhe për të rikthyer dinjitetin e atyre që u shtypën padrejtësisht, një itori për t’u rrëfyer e mësuar.